



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 28.6.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Ismet Beqiri, Alma Lama, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Fatmir Limaj, dhe Suzan Novobërdali.

Stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi: Xhavit Haliti, nënkryetar i parë Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të datës 10.6.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-170, për transplantimin e organeve, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-167, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, me raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesi, lidhur me rendin e ditës, tha kemi njoftimin nga Komisioni Funkcional, se Projektligji nr. 04/L-170 për transplantimin e organeve, me amendamentet e Komisionit Funkcional është tërhequr nga iniciuesi.

Andaj, propozoj që ky projektligj të hiqet nga rendi i ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të datës 10 qershor 2013;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, e ftoi deputetin Albert Kinolli, referues të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli, tha se pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Vjosa Osmani, theksoi se arsyeja pse një numër i madh i deputetëve kanë votuar kundër këtij projektligji, ka qenë neni 8, i projektligjit, me të cilin nen, nuk u është njohur stazhi personave që kanë punuar në periudhën e viteve 1989-1999, qofshin ata në shëndetësi apo në arsim. E kuptoj kompleksitetin e përcaktimit të kriterëve apo edhe të vërtetimit të punëve të atyre njerëzve, megjithatë, nëse ne ua mohojmë punën që e kanë bërë ata gjatë atyre viteve, edhe ne po bëhemi pjesë e një politike diskriminuese, e cila ka ekzistuar gjatë asaj periudhe, mirëpo, atëbotë kjo u është bërë nga regjimi serb.

Ne patëm propozuar, që ajo dispozitë të plotësohet në mënyrë që edhe ajo kategori të përfshihet, do të thotë t'ju njihen ato dhjetë vite punë. Amendamenti që është bërë këtu nga Komisioni Funksional, amendamenti 6, thjeshtë thotë që ajo kategori do të rregullohet me ligj të veçantë. Ne e dimë, që sa herë që dikush lihet për ligj të veçantë, ajo çështje s'do të rregullohet fare. Ndërsa, çështja tjetër që ka të bëjë me përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së, ka të bëjë me parimin e kontributdhënësit. Sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pagesa e pensionit bëhet në bazë të kontributit të dhënë, ku ne sipas nenit 53, të Kushtetutës, e kemi obligim ti përcjellim këto vendime. Edhe këtu e kuptoj kompleksitetin e përcaktimit të kontributit, sepse në një anë ka njerëz që thonë se nuk ka informata, kurse në anën tjetër, ka informata mjaft të besueshme që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale disponon me këto dokumente, me anë të të cilave do të dëshmohej kontributi i dhënë dhe në bazë të parimit të kontributit, të përcaktohet pastaj edhe pensioni. Ky parim nuk është paraparë në këtë projektligj, që nënkupton se ky projektligj nuk është në përputhshmëri me standardet evropiane, gjë që ne duhet ta shikojmë në këtë komision. Për këto dy arsye, unë nuk mund ta votoj këtë projektligj në Komision.

Kryesuesi, tha se nuk mund të flasim për standarde evropiane sepse asnjë shtet nuk e ka pasur gjendjen çfarë e ka pas Kosova dhe nuk mund ta krahasojmë me asnjë shtet në Evropë, i cili ka mundur ti zgjedh problemet e ngjashme çfarë i kemi pasur ne. Është më se e vërtetë, që njerëzit kanë punuar dhe kontribuar qoftë në arsim, qoftë në shëndetësi apo në fushat e tjera, të cilat kontribute me rrogë ose pa rrogë duhet tu njihen patjetër. Jam dakord që të zgjidhen këto probleme, por jam plotësisht dakord, që të kemi një ligj të veçantë për këto kategori. Si politikë e Kosovës, duhet të gjejmë një zgjidhje, Qeveria, do të duhej të jepte një pasqyrë të vërtetë të mundësive për të paguar pensionet dhe të kemi edhe ne parasysh se si të votojmë nesër në Kuvendin e Kosovës. Jam kundër që me formula të tilla të manipulohet për çështje elektorale në Kuvend, për të thënë që dikush po i mbështetë kategoritë e caktuara. Është mirë të shihet, çfarë mund të bëjmë edhe në procesin e miratimit të këtij ligji. Qeveria duhet të jetë shumë e përgatitur që të informoj Kuvendin dhe opinionin se çfarë janë duke përgatitur për këtë kategori, cila është alternative e mundshme, në mënyrë që të mos mbesin edhe ata pa pjesën që ju takon.

Vjosa Osmani, tha se nuk është çështja e standardizimit apo e përafrimit me shtetet evropiane. Nuk ka asnjë rast në Evropë, që me nen të caktuar të Kushtetutës së vet e obligon vetveten, që me i përcjell vendimet e Gjykatës Evropiane, e ne jemi ata. Çdo institucion publik, e ka obligim kushtetues, që aktet të cilat i nxjerrin

të jenë në përputhshmëri me vendimet e Gjykatës Evropiane. Kjo çështje nuk ka fare të bëjë me çështje elektorale, por me një standard, i cili respektohet në shumicën e vendeve. Unë mendoj që kjo çështje në aspektin juridik, ka mundur të zgjidhet shumë më lehtë, e drejta t'ju njihet me ligj, që kanë të drejtë pensioni, mirëpo, kriteret e kushtet të përcaktohen me akt nënligjor. Por, jo tu mohohet me ligj e të thuhet që pastaj do të rregullohet me ligj të veçantë. E drejta në pension, me Kushtetutën tonë dhe Konventën Evropiane, që është pjesë e Kushtetutës sonë, konsiderohet se është pronë. E drejta e pronës, me Kushtetutën tonë, nuk lejon të diskriminohet. Osmani shtoi se në seancë, shumica janë pajtuar me këtë koncept.

Ismet Beqiri, duke përkrahur deputeten Osmani, shtoi se po të cilësohej elektorale, le ta merr Qeveria këtë meritë, vetëm t'ju jepet njerëzve kjo e drejtë. Ajo që ne kemi kërkuar dhe për çka kemi mbajtur debate edhe në Kuvend, është njohja e stazhit për njerëzit që kanë punuar në arsim. Me ligjin e tillë, pensionistët e të gjitha kategorive që kanë punuar, do tu njihet kjo e drejtë. Ne jemi Kuvend dhe po e shohim se kur po dëshirohet të gjinden para, nuk ka ndonjë problem. Kemi parë që janë bërë dislokime me miliona, për projekte të caktuara, edhe për këtë jam i bindur që mund të gjinden mjete, por të parashihen qartë në projektligj. Beqiri propozoi që kjo të përfshihet me një amendament të veçantë dhe të paraqitet në emër të Komisionit.

Kjo ishte një çështje për të cilën u pajtuan të gjitha grupet politike. Çështja e aktit nënligjor derivon nga ligji. Jam i bindur se nëse kjo çështje lihet të rregullohet me akt të veçantë, do të mbesë e parregulluar. Nëse nuk përfshihet ky amendament, unë nuk do ta përkrahi rekomandimin e komisionit, tha Beqiri.

Blerta Deliu-Kodra, tha se Komisioni për Mirëqenë Sociale e ka shqyrtuar projektligjin për skemën pensionale dhe e di që është kaluar pa u diskutuar, se cila kategori do të përfshihet në këtë ligj dhe nëse këtyre kategorive do tu njihet stazhi.

Unë nuk mendoj, theksoi ajo, që ka deputet brenda Parlamentit, që ka qenë kundër përfshirjes së atyre kategorive në këtë projektligj. Unë dyshoj që ne kemi kompetencë për ti rekomanduar Komisionit për Mirëqenë Sociale dhe komisioneve tjera, për tu trajtuar kjo kategori. Mendoj që specifika e vendit tonë, dallon me specifikat e vendeve tjera, theksoi Deliu-Kodra.

Vjosa Osmani, tha se ne kemi pas praktikë edhe në rastet e tjera, kur kemi menduar se një projektligj nuk është në përputhje me aktin më të lartë juridik, e kemi arsyetuar me parimin e hierarkisë juridike. Parimi i hierarkisë juridike është brenda *acquis* së BE-së. Tash, e drejta në pension është e drejtë e pronës, sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane, që neve Kushtetuta na obligon t'i respektojmë ato vendime. Parimi i jo diskriminimit është në Kushtetutë, që po ashtu na obligon edhe neve meqë Kushtetuta, si akti më i lartë ligjor nuk e lejon diskriminimin dhe nuk lejon që prona ti njihet vetëm një kategorie.

Kryesuesi, pasi mori fjalën, tha se ne nuk jemi që të bllokojmë këto kategori. Problemi është se ne nuk kemi informacion sa i përket mundësive financiare. Sa i përket raporteve financiare, ne tha po duhet që ti harmonizojmë ato edhe me Bankën Botërore, e edhe me FMN-në dhe me mundësitë e Qeverisë. Besoj se askush nga komisioni nuk është kundër që të zgjidhet ky problem. Është mirë të kërkojmë, që të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me këtë projektligj, të na i përcjellin apo edhe të kërkojmë që ky projektligj ti kthehet Qeverisë dhe të procedohet në Kuvend, vetëm atëherë kur të jenë përfshirë këto çështje.

Megjithatë, propozoj që në emër të Komisionit të shkoj rekomandimi për projektligjin me amendamentin e propozuar, por shqetësimi im është se ku do të gjinden mjetet për zbatimin e këtyre ligjeve. Prandaj, është mirë që të shkojmë hap pas hapi, me mundësitë që i kemi. Jam që të bëjmë amendamentin në emër të Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk është në kundërshtim me parimet bazë të *Acquis* të BE-së.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, përkrahen nga Komisioni për Integritet Evropian, përveç Amendamentit 6.

Andaj, Komisioni për Integritet Evropian, propozon këtë:

Amendament 1

Në nenin 8, pas paragrafit 5, shtohen dy paragrafë të ri, si vijon:

“(6) Me këtë Ligj u njihet përvoja e punës gjatë viteve 1989-1999, punëtorëve të Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 deri 1999, të cilët kanë punuar në sistemin paralel të arsimit, të shëndetësisë apo në sektorët e tjerë.

(7) Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontribut-pagues të moshës për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 deri 1999, do të rregullohet me akt të veçantë nënligjor.”

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-167, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, me raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional;

Kryesuesi, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Agjencinë Kosovare për krahësim dhe verifikim të pronës, ka për qëllim të përcaktoj organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj agjencie, lidhur me krahësimin dhe verifikimin e pronës.

Pas shqyrtimit dhe pasi që është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj, nuk mbulohet me legjislacionin e BE-së, si rezultat i kësaj nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji Nr . 04/L-167, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Të ndryshme.

a) Strategjia Nacionale për Integritet Evropian

Blerta Deliu-Kodra, thekso se neve si Komision nuk na ka arritur fare Strategjia Nacionale për Integritet Evropian. E di që tani është vonë, por do të ishte mirë që të qitet në Komision, për të parë se çka përmban ajo strategji.

Lutfi Haziri, bëri të ditur se strategjia e MSA-së është dorëzuar te Presidentja. Këshilli Nacional e miraton, ndërsa nga Këshilli Nacional kthehet në Komision Parlamentar dhe pastaj dërgohet në seancë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i parë i Komisionit

Xhavit HALITI